Asambleja
01.Nr.X
Deçan,dt.30.06.2022

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e X-të me radhë, respektivisht mbledhja e VI-të e rregullt e Asamblesë Komunale, me dt.30.06.2022.
Në mbledhje ishin prezent: 26 anëtarë të asamblesë, disa drejtor të drejtorive komunale, OJQ.
Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, z.Hajdar Sutaj.
Për mbledhje ishte propozuar ky rend pune:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2023-2025,
3. Shqyrtimi i Planit për Komunikim dhe marrëdhënie me publikun në komunë.
4. Themelimi I grupit punues për hartimin e Planit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në komunë,
5. Shqyrtimi i Model-Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet urbane,
6. Themelimi i komisionit për zgjedhjen e Kryetarëve të Këshillave të Fshatrave,
7. Shqyrtimi i Planit Lokal të Veprimit Rinorë,
8. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit të Komisionit për emërim të rrugëve,
9. Njoftim i Grupit punues rreth bisedimeve me menaxhmentin e KRU"Hidrodrini" për situatën e furnizimit me ujë të pijes dhe kualitetin e ujit të pijes në Komunën e Deçanit,
10. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit për miratimin e Vendimit paraprak për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës- parcelat nr.1256-0, nr.1257-0 dhe nr.4690-0 Zk Deçan dhe formimi i komisionit vlerësues,
11. Formimi i komisionit për ndarjen e bursave të studentëve,
12. Shqyrtimi i kërkesë së Shoqatave të dalura nga lufta për mbështetje financiare,
13. Të ndryshme.

KPF i Rekomandojnë Kuvendit këtë ndryshim dhe plotësim të pikave të rendit të ditës:
1.KPF rekomandojnë heqjen e Planit Lokal të Veprimit Rinorë (pika nr.7 e rendit të ditës në mbledhjen e Kuvendit), dhe në vend të saj propozojnë si pikë:Themelimi i grupit punues për hartimin e Planit Lokal të Veprimit Rinorë.
2.Kërkesa e komunitetit të fshatit Ratish i Ulët, për shëndrrimin e Objektit të ambulantës së fshatit në një objekt të përbashkët për nevojat e gjithë fshatit (si pikë e re).
3.Themelimi i Grupit të Asamblistëve të rinjë(si pikë e re).

Kryesuesi e hapi mbledhjen e mbledhjen X-të me radhë, gjegjësisht mbledhja e VI-të e rregullt e Kuvendit, duke i përshëndetë pjesëmarrësit, verifikoj pjesëmarrjen e delegatëve dhe konstatoj se në mbledhje marrin pjesë 25 anëtarë të Kuvendit (mungojnë me arsye: Hamid Zukaj dhe Albesa Cacaj).
Kryesuesi- e prezantoj rendin e punës të propozuar me ftesë, si dhe pikat e Rekomanduara nga KPF si pika të shtuara të rendit të ditës, me gjithsejt 16 pika, i njëjti miratohet njëzëri.
Kryesuesi pastaj e prezentoj propozimin e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, për Rialokim dhe ridestinim të mjeteve buxhetore, Njëzëri asamblistët vendosin që kjo kërkesë të hyn në rend dite dhe të shqyrtohet si pikë e veçantë, me këtë formulim:Rialokimi dhe Ridestinimi i mjeteve buxhetore.

I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
Orges Tafilaj- në fq. e parë duhet të bëhet korrektim i korrektimit paraprak te fjala ime, në fq.2 lartë, të shtohet teksti "paraprakisht realizimi i buxhetit 2022 duhet të dërgohet në Ministri".
Hyri Dobrunaj-ka thënë në fq.7 Komisioni për barazi gjinore i formuar mbledhjen e kaluar në të cilin janë vetëm gra, nuk është respektua barazia gjinore dhe besoj se ky vendim për formim te këtij komisioni do te kthehet nga ministria për arsye se nuk respektohet barazia gjinore, ne fund ne si Asamble kemi marrë vendim që mos të shqyrtohen pikat e rendit të ditës kur nuk është prezent drejtori i fushës përkatëse, dhe krejt në fund nuk ka qenë në pyetje Sanije Thaqi si emër arsyeja pse ne si LDK e kemi lëshuar mbledhjen por fakti se përfaqësuesi i OJQ-së është propozuar nga kryetari i grupit të AAK-së.
Miratohet njëzëri procesverbali me plotësime.
II. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2023-2025.
Hyri Dobrunaj- ka thënë se nuk jam e kënaqur me ndarjet te investimet kapitale, te performanca renditemi te fundit. Nuk pajtohemi me këtë ndarje buxhetore dhe ne kërkojmë që ju si ekzekutiv komunal të punoni aq sa kini premtuar në programin tuaj në zgjedhje, në vazhdim ajo ka cekë çështjen e performacës komunale, renditjes në listë në nivel vendi dhe problemet me prokurori për keq menaxhim.
Kryetari i Komunës- ka sqaruar lidhur me renditjen në listë për përformancë komunale, kjo ka ndodhë në 4 a 5 raste për tema me rëndësi vitale për komunën e Deçanit në të cilat nuk jemi tërhjekë për tema funksionale që mendojmë të realizojmë në interes të zhvillimit ekonomik në përgjithësi dhe në veçanti zhvillimin e turizmit, ndërsa për mos me debatu për prokurori, krejt këto po bëhen në të mirën e përgjithshme të zhvillimit të Deçanit.
Mon Selmonaj- pyet, pse nuk na ka ardhë me material edhe kopja fizike e KAB-it, vetëm në formë elektronike na ka ardhë materiali dhe kërkon që materiali çdo herë ti shkon komplet edhe në kopje fizike.
Florim Mataj- meqenëse po flasim për KAB-in po fokusohem te tema që e kemi në diskutim në rend dite, në vazhdim ka propozuar që të rritet buxheti për bujqësi-konkret për kanale të ujitjes të rritet buxheti, për punimin e tokës të dyfishohet buxheti për tri vitet e ardhshme, dhe në të ardhmen drejtori i bujqësisë të angazhohet dhe të gjejë mundësi për të lidhë marrëveshje për rregullimin e të gjitha kanaleve të ujitjes.
Orges Tafilaj- thot se unë kërkoj promovimin e klubeve të reja dhe klubeve tu lejohet hapsira për trajnim në fushat sportive, rritja e buxhetit me KAB 2023-2025 është e mirëseardhur, ka zbritje të hyrave te taksat, te arsimi pyet a ka të hyra, prap kemi me qenë të mvarun nga Ministria për transferet ka thënë ai, kërkon të përkrahen njerëzit me nevojë, të ketë rritje të investimeve kapitale ndërsa rritja e të hyrave është gjë e mirë, subvencionet janë të planifikuara te zyra e kryetarit dhe drejtoria për Buxhet, dhe a duhet ka pyet ai me qenë të planifikuara subvencionet edhe në drejtori tjera, te kapitalet ka cekë investimet në projektin Varrezat e qytetit dhe objektin e komunës, Kanalizimi i ujërave të zeza në 6 fshatrat andej Bistrice a do të fillon në 2023, për rrugën "Qendra" deri te rruga e Gashit a jan të mjaftueshme këto mjete, kolektori Dranoc është i domosdoshëm, te bursat a duhet të rritet numri nga 50 sa është, cili ka me qenë opinioni i raportit të auditorit për vitin 2022.
Kryetari- për krejt këto pyetje që u parashtruan këtu, është mirë që ta ftojmë një mbledhje tjetër, dhe ta bëjmë një debat vetëm për këto tema, kurë ju të dëshironi ta caktoni dhe ta mbani, konkret kurë do që ju e vlerësoni do ta caktojmë një takim për këto tema që u ngritën ose dëshironi sot të përgjigjem një nga një.
Faton Selmanaj- lidhur me pyetjet dhe çështjet e ngritura nga parafolësi, thotë nëse sot kryetari nuk mundet të epë përgjigje, mund ta caktojmë një takim tjetër për këtë temë.
Kryetari- thot se KAB-i sot duhet të miratohet dhe të shkon vendimi sot në Ministri sepse afati i fundit ligjorë për shqyrtimin dhe miratimin e KAM 2023-2025 është data 30 Qershor, në të cilën datë duhet të shkon vendimi bashkë me Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) në Ministri.

Faton Selmanaj- thotë se pajtohem për një takim tjetër sepse vetëm një herë në muaj po mbajmë mbledhje dhe është e vështirë që të përmblidhen të gjitha temat aty.
Miftar Ahmetxhekaj- pyet, nëse sot miratohet KAB 2023-2025, cili do të jetë efekti i debatit për këtë temë në Korrik.
Drejtoresha e Buxhetit, Dafina Cacaj- sqaron se KAB-i është planifikim i hershëm për tri vitet e ardhshme, dhe vjen pastaj Qarkorja e dytë buxhetore ku përcaktohet strikt buxheti për çdo kategori, për këtë arsye Kryetari po thotë që ta mbajmë një takim tjetër dhe bashkërisht mund ti debatojmë propozimet dhe ta planifikojmë buxhetin i cili miratimin final duhet ta merr në Shtator.
Meqenëse nuk kishte të interesuar të tjerë për debat, Kryesuesi e qiti në votim Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2023-2025, anëtarët e asamblesë e miratojnë me shumicë votash, rezultati votimit ishte 15 për(pozita) 10 kundër (opozita).
III. Shqyrtimi i Planit për Komunikim dhe marrëdhënie me publikun në komunë.
Kryesuesi- e ka prezentu ketë pikë pastaj e ka hapë debatin rreth saj.
Mon Selmonaj- ka kërkuar që te punët e Kuvendit të korrigjohet teksti dhe të hyjnë edhe prezantimi i punëve ma detale të kuvendit gjatë dhe pas mbledhjeve të kuvendit.
Kryetari-e pyet a ki vërejtje konkrete apo propozim konkret për ndryshim.
Yllarta Thaqi- në fq.3 në vend të Bordi i drejtorëve duhet të ndryshohet dhe të bëhet Këshilli i drejtorëve, në fund të planit duhet të jetë Mediat të njoftohen dy javë më parë.
Hyri Dobrunaj- thot se kjo është indikatorë te rritja e performancës dhe ajo çka tha Moni është mirë të futet në Plan, sepse edhe mbledhjen e kaluar kur ne e kemi lëshuar mbledhjen nuk është cekë fare ky fakt në lajmin që është bërë lidhur me mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit.
Verona Dobraj, zyrtare për Informim- ka sqaruar se lajmet kur i publikojmë nuk i futim aty edhe detajet, por vetëm në vija të përgjithshme e prezentojmë.
Arjan Dobraj- thot se e përgëzoj kolegen për planin e prezantuar dhe me sa pashë unë i plotëson të gjitha kushtet e Planit për Komunikim dhe marrëdhënie me publikun, propozoj që te zyra për informim të futet edhe informimi rreth punëve të komisionit për emërim të rrugëve, si grup e vlerësojmë si një plan të mirë, e përkrahim si të tillë dhe propozoj që të qitet në votim.
Vatan Istrefaj- thotë se afatet kohore shpesh nuk respektohen te ueb faqja e komunës dhe kërkoj që të respektohen afatet kohore.
Faton Selmanaj-propozoj të futet në plan edhe transmetimi i seancave të kuvendit live, mund të bëhet transmetimi live sepse infrastruktura është në sallë por nevojiten vetëm edhe pak intervenime për tu funksionalizuar transmetimi i seancave të kuvendit live .
Meqenëse nuk kishte diskutime tjera kryesuesi e qiti në votim Planin për Komunikim dhe marrëdhënie me publikun në Komunë, anëtarët e kuvendit e miratojnë me shumicë votash, rezultati i votimit, 20 për (AAK dhe LDK) 3 kundër (LVV) , 1 apstenim (PDK).
IV.Themelimi I grupit punues për hartimin e Planit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në komunë.
Kryesuesi- e ka prezentu piken pastaj sqaron se është pikë e rendit të ditës nga mbledhja e kaluar e muajit maj, e cila është shtyrë në mungesë të drejtoreshës, e cila nuk ka qenë prezent në sallë kur pika ka dalë për shqyrtim.
Drejtoresha e Kulturës ka thënë se plani për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore do ti ketë në vetvete të gjitha prioritetet që ka me i pasë komuna e Deçanit për tri vite.
Miftar Ahmetxhekaj- thotë se propozimi nuk është i argumentuar mirë, pastaj shtron pyetjen se a ka një bazë ligjore për themelimin e këtij grupi, si fakt ka thënë ai Komuna e Deçanit i ka tri Kulla me rrezikshmëri të lartë, një në Voksh, një në Pobergj dhe një në Baballoq, ju mund të bëni promovimin e trashëgimisë prandaj propozoj që fjala "mbrojtjen" të zëvendësohet me fjalën "promovim", jo mbrojtjen e trashëgimisë, pastaj ka kërkuar nga propozuesi që të sqaron edhe pak, se cilat kanë me qenë detyrat dhe kompetencat e grupit.
Drejtoresha-thot se të gjitha këto që i potencove këtu i përfshinë ky plan.
Florim Mataj-u diskutua këtu rreth kompetencave të komisionit, dhe sa ju përket kompetencave është ligji i cili i përcakton këto gjana.

Hyri Dobrunaj- thotë, quani grup ose komision këtë, por ma mirë kishte me qenë që të quhet Komisioni për promovim të trashëgimisë kulturore.
Bekim Vishaj, drejtor i arsimit- thotë se asgjë ndesh nuk bijën me ligjin nëse formohet një grup i nivelit komunal dhe të thuhet promovim ose mbrojtje, vetëm të mos bien ndesh me ligjin.
Miftar Ahmetxhekaj- ti referohemi promovimit- i kemi objektet me rrezikshmëri dhe duhet të kemi kujdes me fjalën promovim.
Kryesuesi- e pyet kuvendin, a do ta formoni si grup ose komision, kuvendi shprehen se komision do ta quajnë
Formohet komisioni për hartimin e Planit për promovimin e trashëgimisë kulturore në komunë,
në këtë përbërje: Leotrim Hadergjonaj(AAK), Arjan Dobraj (AAK), Skender Kurmehaj (LDK), Bekim Vishaj (Ekzekutivi) dhe Shkelzen Shehu(Ekzekutivi). Kjo përbërje e komisionit miratohet me 21 vota për(AAK, LDK, PDK)), 3 abstenim (LVV).
V. Shqyrtimi i Model-Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet urbane.
Kryesuesi- e prezentoj pikën pastaj për sqarime fjalën ia ka dhënë drejtorit të drejtorisë për Administratë, Jashar Dobraj, i cili ka sqaruar se ne si Komunë e kemi pasur një rregullore të tillë por ka ndryshuar ligji dhe Udhëzimi administrativ Nr.02/2019 për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, që parashohin ndryshime të themelimit dhe organizimit të Këshillave Lokale, të cilët duhet të formohen sipas numrit të popullsisë që ka çdo komunë, Komuna e Deçanit sipas këtij udhëzimi duhet të formon 20 Këshilla Lokale, si ndryshim i ri nga e kaluara dhe reduktim i Këshillave lokale, pastaj parashihet kompenzimi i kryetarëve të Këshillave Lokale, përfaqësimi gjinorë duhet të jetë në Këshillat Lokale dhe në përbërjen e komisionit.
Kryesuesi- kërkon sqarim si do të bëhet bashkimi i disa fshatrave në një Këshill Lokal.
Faton Selmanaj- pyet për numrin e banorëve që përcaktojnë numrin e Këshillave lokale sa do të jetë numri.
Drejtori- sqaron se sipas pikës 3.4 të Udhëzimit Administrativ Komuna që ka 30.000 deri 50.000 banorë duhet të ketë 20 Këshilla Lokale, në këtë grup bëjmë pjesë ne si Komunë.
Mon Selmonaj- thotë, nuk pajtohem hiq me këtë udhëzim, sepse për mua është e pamundur të implementohet dhe mu kthye organizimi si ka qenë para lufte në Bashkësi Lokale, prandaj them se me ketë organizim është vështirë se mund ta implementon në praktikë.
Florim Mataj-thotë, na duhet të ju përshtatemi ligjit dhe Udhëzimit Administrativ, dhe jemi obligativ me i zbatua, por bashkimi i disa fshatrave në një Këshill Lokal paraqet problem në vete, mirëpo mund të gjendet një formë e pranueshme, të bëhet me rrotacion të jetë Kryetari i Këshillit Lokal, në të gjitha ato Këshilla Lokale ky hyjnë dy e ma shumë fshatra.
Teuta Neziraj- kërkon sqarim, kompensimi i kryetarëve të Këshillave Lokale si do të bëhet deri sa ne jemi dëshmitarë se kemi komisione të kuvendit që duhet të kompensohen dhe një gjë e tillë nuk është bërë kurrë edhe pse komisionet kanë qenë funksionale dhe i kanë mbajte takimet.
Drejtori, Jashar Dobraj- përgjigjet se kompensimi i Kryetarëve të Këshillave Lokale do të planifikohet në buxhet, pagesa do të bëhet në nivel të pagesës së komiteteve obligative dhe do të kompensohen për 6 takime brenda vitit.
Miratohet rregullorja në leximin e parë, e njëjta duhet ti nënshtrohet procedurës së diskutimit publik.
Miratimi bëhet me 24 vota për (AAK, LDK, LVV), 1 abstenim (PDK).
VI. Themelimi i komisionit për zgjedhjen e Kryetarëve të Këshillave të Fshatrave.
Kryesuesi- e ka prezentu këtë pikë pastaj ka sqaruar se komisioni sipas Udhëzimit Administrativ duhet të përbëhet nga 7 anëtarë, 4 nga Asambleja nga subjekte të ndryshme politike, një nga Ekzekutivi, një nga sektori jo qeveritar dhe një anëtar ad hoc nga lokacioni ku bëhet zgjedhja e Këshillave Lokale, Kryesuesi ka thënë se nga ekzekutivi është i propozuar Jashar Dobraj, ndërsa pas konsultimeve që kemi zhvilluar sot para mbledhjes me OJQ-të lokale, është propozuar nga OJQ-të për anëtare e këtij komisioni, Safete Gacaferi.
Hyri Dobrunaj- thotë se mbledhjen e kaluar janë votuar për këtë komision dy emra nga AAK dhe një OJQ, çka do të bëhet me ata emra të votuar.

Kryesuesi- përgjigjet se janë propozuar dhe votuar mbledhjen e kaluar dy emra nga AAK-Fekri Qufaj dhe Afrim Demhasaj ndërsa përfaqësuesi nga sektori joqeveritar nuk është votuar, sot komisioni plotësohet edhe me anëtarët tjerë dhe votohet themelimi i komisionit i plotë.
Propozohen edhe dy anëtarët tjerë të komisionit nga asambleja, Miftar Ahmetxhekaj (LDK) dhe Faton Selmanaj(LVV)
Miratohet njëzëri themelimi i komisionit për zgjedhjen e Kryetarëve të Këshillave të Fshatrave, në këtë përbërje : Fekri Qufaj dhe Afrim Demhasaj nga AAK, Miftar Ahmetxhekaj nga LDK , Faton Selmanaj nga LVV, Jashar Dobraj nga Ekzekutivi , Safete Gacaferi OJQ lokale dhe një anëtar do të jetë Ad hoc, varësisht nga lokacioni ku bëhet zgjedhja e Këshillave Lokale.
VIII.Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit të Komisionit për emërim të rrugëve.
Kryesuesi e ka prezentu këtë pikë pastaj për sqarime fjalën ia ka dhënë Kryesueses së komisionit, znj.Yllarta Thaqi, e cila ka sqaruar se komisioni ka punuar në përbërje të plotë, i kemi shqyrtuar 17 kërkesa për emërim dhe riemërim të rrugëve, vetëm 4 kërkesa i kanë plotësuar kriteret që përcaktohen me ligj dhe rregullore, ato katër kërkesa i kemi proceduar me material sot këtu për emërim të rrugëve, 3 kërkesa janë miratua në parim por ka mbetë që të dalim në teren edhe një herë për verifikim, ndërsa kërkesat tjera nuk i kanë plotësuar kriteret e përcaktuara për emërim të rrugëve, kurse ne si komision nuk kemi adresa ose numër të telefonit të palëve që ti njoftojmë për kërkesat e refuzuara dhe arsyen pse kërkesa e tyre nuk i ka plotësuar kriteret.
Kryesuesi- kërkon sqarim, cilat rrugë dhe në cilat fshatra janë rekomanduar për emërim, për kërkesat e pa miratuara si do të shkon procedura dhe kush do ti njofton palët se nuk i ka plotësuar kriteret kërkesa e tyre dhe kurë do të dilni në teren për tri rrugët e miratuara në parim.
Yllarta Thaqi- sqaron se sipas komisionit, pas shqyrtimit të kërkesave 4 rrugë i kanë plotësuar kriteret, këto janë: 1. Në fshatin Carrabreg i Epërm, rruga e pa emëruar deri me tani, me gjatësi mbi 500 m, emërohet me emërin e veteranit të UÇK-së "Xhavit Dobraj", 2.Në qytetin e Deçanit, rruga e re e cila gjendet në mes të shkollës "Lidhja e Prizrenit" dhe QKMF "Adem Ukëhaxhaj" në Deçan, me gjatësi mbi 500 m, emërohet me emrin e Dëshmorit të Kombit "Halil Sejfijaj".
3.Në fshatin Maznik rruga ekzistuese me emrin "Azem Sylaj", me gjatësi mbi 650 m. Riemërohet dhe zëvendësohet me emrin e rapsodit të ndjerë "Kushtrim Sylaj".4.Në fshatin Prejlep rruga ekzistuese me emrin "Beteja", me gjatësi mbi 250 m. Riemërohet dhe zëvendësohet me emrin "Kreshnik Qufaj".Tri kërkesat tjera të miratuara në parim, do të dalim në teren si komision dhe në mbledhjen e muajit korrik do ti bijmë në kuvend, ndërsa sa ju përket kërkesave tjera të cilat nuk i kanë plotësuar kriteret , nuk kemi adresë as numër të telefonit të palëve.
Orges Tafilaj, anëtar i komisionit- sqaron për mënyrën e punës së komisionit, ai ka sqaruar se si komision i kemi bërë do instruksione se si duhet të vijnë kërkesat e palëve.
Florim Mataj- thotë se kërkesat që refuzohen duhet të ju bëhet përgjigja me shkrim palëve dhe duhet të tregohet kujdes aty ku bëhet riemërim i rrugëve.
Erdogan Dautaj- thotë se materiali i ka shkuar i shtypur dobët dhe nuk shifet mirë çka shkruhet aty, prandaj propozoj që kjo temë të shtyhet për mbledhjen tjetër. Pastaj ka pasë vërejtje te emërtimi i emrave të rrugëve që po bëhen por tabelat në rrugë nuk po vendosen, dhe kjo gjë nuk është e njëjtë për të gjithë sepse ka raste që bëhet emërim i rrugës dhe brenda dite vendoset edhe tabela.
Miftar Ahmetxhekaj- te rekomandimet e komisionit kërkon që të shikohet aspekti gjuhësorë, në rekomandim të ceken edhe kërkesat e qytetarëve kush i ka bërë me emër, datë dhe numër të protokollit, kërkon nga komisioni që të i referohen ligjit kur bëhet emërim i rrugëve sepse nuk janë të mjaftueshme nënshkrimet dhe shtron pyetjen, a plotësohet kriteri 10 shpi tek rrugët e rekomanduara për emërim.
Yllarta Thaqi- thotë se është hera e parë që e kemi bërë si komision një rekomandim të tillë dhe jemi përpjekur që të jemi brenda Ligjit për Sistemin e Adresave, Nr.04/L-071 dhe Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.14/2019 për Caktimin e Emërtimit dhe numërtimit të adresave për zona të qarkullimit publik, ndërtesa, shtëpi, objekte dhe parcela kadastrale të lira.
Faton Selmanaj- thotë se pajtohem me Erdoganin për vendosje të tabelave sepse ka rrugë që ju ka ndryshua emri por tabela në teren nuk ka ndryshua.

Arjan Dobraj- thotë se kemi rrugë që është emëruar vitin e kaluar por nuk ju ka vendosë hala tabela.
Yllarta –sqaron si kanë vepruar si komision gjatë shqyrtimit të kërkesave dhe si komision e kanë nxjerrë një udhëzues si do të bëhen kërkesat e palëve tash e tutje.
Mon Selmonaj- thotë se e potencoj kryesuesja e komisionit se ne si komision e kemi nxjerrë një udhëzues se si duhet të pranohet kërkesa për emërim të rrugës, dalja në teren e komisionit është e obliguar për të sqaruar disa dilema të pa sqaruara me kërkesë, por kërkesat e palëve po vijnë shumë të mangëta dhe si komision po kemi vështirësi në vendosjen e tyre.
Kryesuesi i Kuvendit- i drejtohet komisionit, çka do që ju nevojitet për dalje në teren do të kujdesem unë për të jua sigurua mjetet.
Hyri Dobrunaj-kërkon sqarim, rruga te QKMF prej ku fillon dhe ku mbaron, për të cilën përgjigjet Yllarta se fillon nga rruga kryesore dhe vazhdon deri në kyqjen në rrugën përballë.
Hyri Dobrunaj- por nuk ka shtëpi dhe nuk i plotëson kushtet.
Orges Tafilaj- sqaron se ligji thotë që rruga e re që ka qasje në dy rrugë ekzistuese i plotëson kriteret për emërtim, dhe sipas ligjit kjo rrugë i plotëson kushtet për emërim sepse ka qasje në dy rrugë ekzistuese.
Meqenëse nuk kishte diskutime tjera, kryesuesi e qiti në votim rekomandimin e Komisionit për emërim të katër rrugëve, anëtarët e asamblesë e miratuan njëzëri ate, me këtë vendim bëhet emërimi i këtyre rrugëve: 1. Në fshatin Carrabreg i Epërm, rruga e pa emëruar deri me tani, me gjatësi mbi 500 m, emërohet me emërin e veteranit të UÇK-së "Xhavit Dobraj".
2. Në qytetin e Deçanit, rruga e re e cila gjendet në mes të shkollës "Lidhja e Prizrenit" dhe QKMF "Adem Ukëhaxhaj" në Deçan, me gjatësi mbi 500 m, emërohet me emrin e Dëshmorit të Kombit "Halil Sejfijaj". 3.Në fshatin Maznik rruga ekzistuese me emrin "Azem Sylaj", me gjatësi mbi 650 m. Riemërohet dhe zëvendësohet me emrin e rapsodit të ndjerë "Kushtrim Sylaj".
4. Në fshatin Prejlep rruga ekzistuese me emrin "Beteja", me gjatësi mbi 250 m. Riemërohet dhe zëvendësohet me emrin "Kreshnik Qufaj". Ndërsa pyetje për mbledhjen tjetër Vendosja e tabelave të rrugëve dhe numrave të shtëpive, për të cilën kërkojnë sqarim nga ekzekutivi.
IX. Njoftim i Grupit punues rreth bisedimeve me menaxhmentin e KRU"Hidrodrini" për situatën e furnizimit me ujë të pijes dhe kualitetin e ujit të pijes në Komunën e Deçanit.
Kryesuesi- pas prezentimit të pikës ka sqaruar se bashkë me Mon Selmonaj dhe Faton Selmanaj kanë kontaktuar menaxhmentin e KRU "Hidrodrini", kemi dalë edhe në teren ka thënë ai për të parë për së afërmi gjendjen si qëndron.
Mon Selmonaj- sqaron rreth takimit me menaxhmentin e KRU "Hidrodrini", fokusimi jonë ka qenë në 6 pika ka thënë ai, cilësia e ujit të pijes, furnizimi i mjaftueshëm me ujë të pijes, të ketë menaxhim funksional, rritja e mbështetjes për Deçanin, mundësia e funksionimit të Hidrodrinit si Kompani komunale, kemi biseduar për investime në sistemin e ujësjellësit në komunën e Deçanit, kemi pasë vizitë në Qendër në Deçan dhe në kaptazhën e Dranocit.
Erdogan Dautaj- a kini marrë përgjigje për pyetjet e shtruara dhe me kënd kini bisedu, me Bord apo Kryeshef.
Mon Selmonaj- përgjigjet se kemi kontaktu me zv.drejtorin e QKMF-së dhe ai ka thënë se zyrtarisht këto kohët e fundit nuk ka infektim, kemi kontaktu me Kryetarin e Komunës mirëpo komisioni nuk ka qenë i plotë dhe Kryetari na ka thënë që ta hartojmë një shkresë dhe me shkresë ti drejtohemi Hidrodrinit, pastaj si Komision për çka i jam mirënjohës kam kontaktu Petritin-ushtrues detyre i drejtorit, kemi shkuar edhe në Pejë në takim me Bordin dhe ata na kanë thënë se shkëputja nga KRU "Hidrodrini" dhe krijimi i Ndërmarrjes Lokale është jo ligjore
Erdogani- shprehet se pyeta pa keqkuptim.
Mon Selmonaj- thotë se kam kërkuar mi shti në menaxhim të KRU "Hidrodrini" edhe ujësjellësin e fshatit Pobergjë por ata në fshat i kanë kundërshtu.
Fekri Qufaj- pyet, sipas bisedimeve të zhvilluara nga ju me përfaqësuesit e Hidrodrinit , kërkojmë të dimë a kemi ujë në ujësjellësin e 10 fshatrave apo jo.
Mon Selmonaj- përgjigjet se tenderi për mjetet e vitit të kaluar që i ka premtua qeveria me rastin e infektimit masiv të qytetarëve të Deçanit nga uji i pijes, nuk është realizua, qeveria i ka kthye mjetet

financiare pas, dhe ata te Hidrodrinit tash na i kanë dhanë 50.000 € për investim në sistemin e ujësjellësit.
Hyri Dobrunaj- thotë se Kompania ka qenë komunale dhe kur e ka marrë regjioni e ka marrë me minus 200.000 euro minus në paga për punëtorë dhe kjo tregon se aty ku menaxhon komuna ka ngecje të procesit.
Drejtori, Jashar Dobraj- sqaron se deklarimi i Kryeshefit për borgjet nga komuna e Deçanit nuk qëndron . Ai duhet ti referohet nga kush i ka marrë ato borgje sepse me pagesat nga Deçani dhe të hyrat e realizuara nga ujësjellësi nga Komuna e Deçanit, janë mbulua shpenzimet e ujësjellësit nga komuna e Klinës, nuk di nga kush kanë rrjedhë këto informata vetëm dy vjet që kemi menaxhua na si komunë me ujësjellësin punët kanë shkua shumë ma mirë.
Hyri Dobrnaj- thotë se e keni keqpërdorë kontratën për rregullimin e ujësjellësit të Strellcit.
Drejtori, Jashar Dobraj- thotë se menaxhimin e kontratës e ka ba Hidrodrini jo ne.
Mon Selmonaj- ka lexuar shkresën , çka ka deklarua kryeshefi i Hidrodrinit.
Drejtori, Jashar Dobraj- thotë se duhet te behet ndarja nga KRU Hidrodrini dhe të krijohet si kompani lokale duke e arsyetuar atë me menaxhim më të suksesshëm.
Florim Mataj- thotë, po më duket pa kuptim debati, pa paragjykim, ne mund ta thirrim një mbledhje për këto tema dhe ti debatojmë së bashku të gjitha por sot është si temë çështja e furnizimit me ujë të pijes, ndërsa sa i përket ujësjellësit të fshatit Pobergjë nuk kam informatë se inkason diçka aty komuna, vetëm Hidrodrini e bënë inkasimin e shpenzimit të ujit të ujësjellësit, ndërsa mua sot më intereson një gjë, furnizimi me ujë të pijshëm dhe cilësia e ujit cila është.
Kryeuesi- ka sqaruar rreth takimit që kanë pasë me menaxhmentin e Hidrodrinit, falënderon Monin dhe Fatonin për kontributin e dhënë në këtë drejtim, dhe çka kishte ndodhë këtu ka thënë ai, na si komunë kishim qenë përfitues të një donacioni, i cili nuk ishte realizu, çështje në vete është edhe keqpërdorimi i ujit të pijes për vaditjen e kopshtijeve, pastaj sqaron se është informuar se na si komunë i kishim edhe dy bazena për grumbullim të ujit që nuk ishin në funksion, fokusi i diskutimit tonë ka qenë ujësjellësi i rajonit të Vokshit, ujësjellësi i 10 fshatrave dhe ujësjellësi i Strellcit, për ujësjellësin e Strellcit u informuam se nuk ka burime tjera me i marrë sepse 4 burime që janë në atë pjesë të katërtat janë në gypa, ujësjellësi i Vokshit nuk është në menaxhim të Hidrodrinit dhe krejt është në mëshirën e qytetarëve. Na e kemi marrë obligim mi thirre përfaqësuesit e rajonit të Vokshit dhe Kryeshefin e Hidrodrinit për gjetjen e mundësisë së arritjes së një marrëveshje për futjen në menagjim të KRU "Hidrodrini" të ujësjellët të Vokshit, ujësjellësi i fshatit Lëbushë ishte ujësjellës në vete dhe nuk ishte në menaxhim të Hidrodrinit. Nëse kishim pasë mundësi që të arrijmë dhe të pavarsohemi si Deçan nga KRU Hidrodrini besoj se do të funksiononte ma mirë furnizimi me ujë të pijshëm dhe menaxhimi i ujësjellësit, dhe për të gjitha këto shqetësime unë kam dëshirë që bashkarisht me i nxjerrë vendimet.
Orges Tafilaj- thotë se në ujësjellësin e fshatit Lëbushë investimi është bërë me një donacion nga të huajt ndërsa si pyetje, nga krejt takimet që keni patur dëshiroj të di, a është uji i pijshëm apo jo.
Kryesuesi- përgjigjet se uji është i pijshëm.
Halil Tolaj- thotë se ata të kompanisë kurrë nuk kanë thanë keq, edhe pse në disa raste nuk ka qëndru gjendja ashtu siç është deklaruar.
Yllarta Thaqi- thotë se analizat e para atëherë kur është bërë infektimi i qytetarëve, njëra prej të cilëve kam qenë edhe unë, ka qenë se uji është i kontaminuar-sheriakolli ka dalë.
Miftar Ahmetxhekaj- në këtë kohë është shqetësuese që ende merremi me gjendjen e ujit të pijes, pastaj ka shtuar se duhet të bëhet matja e ujit dhe dihet sa ka ujë, kjo është kompani regjionale dhe nuk është gjë e thjeshtë që të mund të arrihet mundësia dhe të kthehet në komunale, mirëpo unë kërkoj që të ushtrohet autoriteti, për vendosje të orëmatësve dhe për cilësi të ujit.
Vatan Istrefaj-thotë se në fshatin Strellc pagesa për ujë vjen paushall dhe mjetet që janë nda për rregullimin e këtij ujësjellësi ka pasë keqpërdorime të mëdha, dhe arsyeja kryesore pse ne si fshat nuk kemi ujë janë keqpërdorimet që bëhen nga qytetarët e pa ndërgjegjshëm.
Faruk Hasanramaj –thotë se si Strellc jemi para pagues të rregullt të pagimit të faturave të ujit, e megjithatë prap nuk kemi ujë.

Teuta Nezirat- thotë, shumë mirë që ju ka pritë Kryeshefi i KRU "Hidrodrini" në takim sepse kryetari pat deklarua se ata nuk na presin në takim, dhe është mirë që kryetari me na thanë që po shkëputemi si ujësjellës në Kompani Komunale, sepse kryetari çdo herë deklaron se duhet të shkëputemi, dhe është absurde në këtë kohë që po jetojmë dhe mos me pasë ujë të pijes.
Drejtoresha Dafina Cacaj- ka sqaruar për angazhimet që kemi bërë ne si komunë për shkëputje nga KRU "Hidrodrini"pas përballjes me infektimin masiv të qytetarëve me ujë të pijes, pengesat që kemi hasur në këtë drejtim, por ne nuk do të ndalemi deri në realizimin e qëllimit tonë.
Shkodran Mustafaj- pasi që jemi në kohë të verës dhe kemi mungesë të ujit, vetëm protesta ka mbete si mjet.
Floriana Hulaj-thotë se për problemin që kemi ngritë na si komunë nuk kemi ingirenca.
Orges Tafilaj-thotë, nëse Ministria e kthen një vendim, për të cilin kërkon që të rishqyrtohet dhe të harmonizohet me ligjin, ata e kanë një arsye për këtë gjë, mirëpo menaxhimin për ujë të pijshëm dhe zgjidhjen e kësaj çështje duhet ta gjejmë bashkarisht.
Kryesuesi- meqenëse u debatua mjaft dhe u shterr debati rreth kësaj çështje e mbylli debatin.

X. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit për miratimin e Vendimit paraprak për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës- parcelat nr.1256-0, nr.1257-0 dhe nr.4690-0 Zk Deçan dhe formimi i komisionit vlerësues.

Kryesuesi- e prezenton pikën pastaj sqaron se duhet të merret vendimi paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale si dhe kërkohet formimi i komisionit vlerësues për zhvillimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim të pronës në fjalë, meqenëse sot është mbajtë takim me përfaqësuesit e OJQ-ve lokale, takim i cili është realizuar me ftesë publike, nga OJQ-të ka dalë propozimi për një anëtarë të komisionit nga sektori joqeveritar, Jehona Dabiqaj, ndërsa Ekzekutivi kanë propozuar Izet Zenuni dhe Hasan Hulaj, mbetet që komisioni të plotësohet edhe me dy anëtar nga asambleja nga subjekte të ndryshme politike, në vazhdim e ka hapë debatin rreth temës.
Hyri Dobrunaj-kërkon sqarim për parcelën 4690-0, a është dhënë në shfrytëzim një herë kjo parcelë.
Hasan Hulaj, i autorizuar i kryetarit – sqaron se janë zhvilluar procedurat dhe është dhënë në shfrytëzim vetëm pjesa nga kjo parcelë ku është ngritur objekti, ndërsa hapësira tjetër është e lirë me zhvillu procedura.
Mon Selmonaj- kërkon që së pari me na sqarua ku ndodhen këto prona dhe cili është interesi jonë si komunë që ti japim në shfrytëzim.
Teuta Neziraj- thotë se edhe unë e pata për ta ngritë të njëjtën pyetje që e parashtroj Moni.
Florim Mataj- thotë se ketë pronë e kemi votuar një here kur e kemi votua listën e pronave komunale që planifikohen të epen në shfrytëzim gjatë vitit 2022.
Hasan Hulaj- sqaron ku gjinden pronat që planifikohet të zhvillohen procedura për dhënie në shfrytëzim.
Erdogan Dautaj- kërkon që materiali për dhënien e këtyre pronave në shfrytëzim me na ardhë pak ma i qartë.
Miftar Ahmetxhekaj- pyet, cili është objekti që planifikohet dhe ku gjindet ai, çfar përfitojmë ne si komunë në këtë rast dhe kërkon që dokumentacioni asamblistëve me ju shku edhe me ortofoto.
Hasan Hulaj- sqaron se objekti gjendet në qendër të qytetit dhe është ai i cili janë të vendosura zyrat e PDK-së.
Hyri Dobrunaj- thotë se është mungesë që nuk po vjen procesverbali KPF-së, sepse aty kur është shqyrtuar kjo pikë unë kam kërkuar material shtesë-ortofoto e parcelës që planifikohet të zhvillohen procedurat e dhënies në shfrytëzim, sepse neve na intereson saktë se ku gjendet prona dhe pa qenë me ortofoto nuk e dijmë ku gjendet, ndërsa sa i përket asaj që një anëtar i LDK-së të jetë pjesë e komisionit vlerësues, ajo ka deklaruar se LDK ka marrë vendim mos me marrë pjesë në këtë proces sepse nuk kemi dokumentacion të mjaftueshëm për të.
Orges Tafilaj- thotë për të njëjtat arsye si LDK nuk marrim pjesë edhe na si LVV në këtë komision.
Propozohet Leotrim Hadergjonaj nga AAK.

Kryesuesi e qiti në votim propozimin e ardhur nga kryetari i komunës, antarët e asamblesë e miratuan me 13 vota për (pozita) dhe 8 kundër (opozita), me të cilin miratuan propozimin e Kryetarit për miratimin e Vendimit paraprak për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës- parcelat nr.1256-0, nr.1257-0 dhe nr.4690-0 Zk Deçan, poashtu formohet edhe komisioni vlerësues, në këtë përbërje: Shkodran Mustafaj dhe Leotrim Hadergjonaj nga Asambleja-AAK, Izet Zenuni dhe Hasan Hulaj nga Ekzekutivi dhe Jehona Dabiqaj-OJQ.

XI. Formimi i komisionit për ndarjen e bursave të studentëve.

Formohet komisioni për ndarjen e bursave të studentëve, në këtë përbërje:Armend Loshaj(AAK), Hyri Dobrunaj(LDK), Manjolla Shala nga Zyra e Kryetarit, Zeqë Malaj nga ekzekutivi-DKA, Rexhep Daci-OJQ. Vendimi për formimin e komisionit merret me 19 vota për (AAK, LDK) 3 abstenim (2 LVV, 1 PDK).

XII. Shqyrtimi i kërkesës së Shoqatave të dalura nga lufta për mbështetje financiare, në shumën prej 13.000 euro.

Orges Tafilaj-thotë parimisht jam për përkrahje të këtyre vlerave por sipas kalkulimit nuk përputhet kërkesa 13.000 euro me kalkulimin që ka ardhë, e cekur në kërkesë, me material të mbledhjes.

Blinera Lokaj- thotë se sipas kërkesës, kjo është shuma e mjeteve të kërkuara duke lexuar shumat e cekura, pastaj shton pyetjen sa është numri i veteranëve dhe si do të bëhet kategorizimi i tyre.

Miratohen 13.000 euro për katër shoqatat e dalura nga lufta, vendimi merret njëzëri.

XIII.Formimi I grupit të Asamblistëve të rinjë.

Kryesuesi e ka prezentu këtë pikë pastaj sqaron se kjo pikë ka hy në rend dite me propozim të Faton Selmanaj.

Njëzëri merret vendim për formimin e grupit të asamblistëve të rinjë, Grup që sipas kriterit të moshës nën 30 vjeçare, e përbëjnë: 1.Armend Loshaj, 2.Hamid Zukaj, 3.Arjan Dobraj, 4.Lendita Berisha, 5.Elmedina Sadikaj, 6.Floriana Hulaj, 7.Vatan Istrefaj, 8.Shkelqim Tolaj, 9.Blinera Lokaj, 10.Teuta Neziraj.

Mbledhjen e parë të Grupit e thirrë kryesuesi i Kuvendit, në të cilën mbledhje grupi e zgjedhë kryesuesin e vet nga radhët e veta.

XIV.Kërkesa e fshatit Ratish i Ulët për përdorimin e objektit të ambulantes së fshatit për nevoja të qytetarëve .

Kryesuesi- e ka prezentu piken pastaj sqaron se komuniteti i fshatit Ratish i Ulët na janë drejtuar me kërkesë për të marrë vendim që objektin e ambulantes së fshatit të jau japim në përdorim të qytetarëve për nevojat e tyre dhe kjo për arsye se atje ai objekt nuk përdoret fare për destiancionin që është ndërtu dhe nuk ka as mjek dhe as motër medicinale , kështu që objekti vetëm po shkatërrohet pa u përdorë.

Florim Mataj- thotë se jam për, meqenëse objekti nuk është funksional për destinacionin që është ndërtu, por ishte dashtë ta kemi një plan program si do ta përdorin dhe si do të bëhet menaxhimi .

Miftar Ahmetxhekaj- pyet, cili është statusi pronësor i objektit.

Orges Tafilaj- pyet, a është punuar ndonjëherë në atë objekt sipas destinacionit të ndërtimit si ambulantë dhe qe sa kohë nuk është funksionale.

Drejtoresha e Shëndetësisë- përgjigjet se objekti është ndërtu para lufte dhe nuk është funksional qe 10 vjet.

Mon Selmonaj- thotë, në parim jam për, por kërkoj të njoftohem se a bëhet fjalë vetëm për objekt apo edhe për hapësirën për rreth.

Hyri Dobrunaj- thotë se është mirë që të shikohet çështja e pronësisë, por nëse miratohet komuna ta mbështetë edhe me mjete financiare.

Njëzëri miratohet (21 prezent) kërkesa e fshatit Ratish i Ulët, me të cilën objekti i ambulantes së fshatit Ratishë i Ulët epet në përdorim të komunitetit, për nevojat e fshatit Ratishë i Ulët.

XV.Rialokimi dhe ridestinimi i mjetëve buxhetore .

Drejtoresha e buxhetit, Dafina Cacaj- sqaron se kërkohet që të bëhet rialokim dhe ridestinim i mjeteve në tri projekte me kode të ndryshme, në vazhdim ajo hollësisht ka sqaruar si ka ardhë deri te ajo që mjetet të mos shpenzohen në projektet që janë planifikua.

Mon Selmonaj- thotë, te projekti i Ujësjellësit të Vranocit –Penda, nuk e dhatë arsyeshmërinë e plotë dhe thatë që këto mjete shkojnë për Objektin e Zjarrfikësve, edhe vjet na i kemi nda mjetet për rregullim të objektit të zjarrfikësve dhe shtroj pyetjen se a është implementu ai vendim apo jo, prandaj lidhur me krejtë këto edhe e shtroj pyetjen se sa po implementohen vendimet e kuvendit.
Drejtoresha- sqaron se Penda në Vranoc është krye dhe ato mjete duhet ti ridestinojmë në një projekt tjetër.
Hyri Dobrunaj-pyet, a ka rishikim të buxhetit.
Drejtoresha, përgjigjet, jo, sepse nuk ka buxhet.
Hyri Dobrunaj- thotë se materiali i mbledhjes ka ardhë me vonesë, nuk kam pasë mundësi ta lexoj dhe analizoj, prandaj për shkak të parimeve më duhet të votoj kundër.
Miftar Ahmetxhekaj- pyet, te ndriçimi publik, a ka specifikacion, kërkoj që kërkesa të jetë pak ma e sqaruar që të mund ta bindi veten që dua me votua për, dhe a e dëmton buxhetin fakti që s'ka rishikim.
Trimor Gjikokaj, ing. Sqaron për renovimin e objektit të zjarrfikësve për vitin e kaluar për të cilin nuk ka pasë projekt detal dhe nuk është lejuar investimi, për këtë vit tani e kemi projektin zbatues, te projekti i Objektit të zjarrfikësve përfshihen punët në vlerë 120.000 euro dhe jemi në përfundim të projektit.
Mon Selmonaj- pse nuk i kini ba komplet paramasat fiks mos me pasë nevojë për punë shtesë.
Trimori- teknikisht bëhet projekti zbatues pastaj fillojnë procedurat e implementimit.
Hyri Dobrunaj- objekti nuk i ka as 10 vjet që është ndërtua, por po shihet si kryhen punët këtu dhe shpresoj se kjo është hera e fundit me kësi investimi, kjo është keqpërdorim i parasë publike të qytetarëve.
Miftar Ahmetxhekaj-thotë, ende nuk ekziston projekti zbatues, a ka rrezik mu orientu 120000 euro në at projekt
Njëzëri miratohen ridestinimi i mjeteve buxhetore (21 prezent), sipas kërkesës dhe propozimit të drejtorisë për Buxhet dhe Financa.
XVI.Të ndryshme.
Yllarta Thaqi- thotë se e kam pasë një kërkesë për drejtorin e arsimit por nuk qenka prezent këtu, për Jashar Dobraj pyetje- lirimi nga pagesa e nxjerrjes së dokumenteve në procedurë administrative, lirimi nga pagesa vetëm e veteranëve të luftës, pyetje për drejtorin , a ka mbulesë që të lirohen edhe anëtarët e familjes së ngushtë- ata që i ka të shkruar në kartelë veterani.
Drejtori, Jashar Dobraj- përgjigjet se kuvendi e ka miratuar një rregullore për taksa dhe tarifa komunale, aty caktohen këto tarifa dhe nëse hiqen edhe pagesa për anëtarët e ngushtë të familjes së veteranit atëherë ajo duhet të përcaktohet me rregullore e cila duhet të ndryshohet dhe plotësohet për atë tarifë.
Miftar Ahmetxhekaj- thotë se ligji për Veteranët e luftës e cpecifikon ndryshe këtë gjë dhe nëse ligji dhe rregullorja komunale bijnë ndesh në ndonjë dispozitë, atëherë duhet të zbatohet ligji.
Hyri Dobrunaj- thotë se rastet kur është veteran dhe rast social duhet të lirohen nga taksat administrative, përndryshe vetëm 9% nuk janë veteran këtu.
Kryesuesi- sugjeron që të formohet një komision i cili do të merret me përgaditjen e ndryshim plotësimeve të rregullores për taksa dhe ta bjen në kuvend për shqyrtim, formohet komisioni për hartimin e ndryshim plotësimeve të Rregullores komunale për taksa dhe tarifa, në këtë përbëje: Yllarta Thaqi, Afrim Demhasaj, Arjan Dobraj, Shkodran Mustafaj, , Teuta Neziraj, Mon Selmonaj, LDK duhet ta sjellin emrin e anëtarit të komisionit.
Miftar Ahmetxhekaj- kërkon që drejtorët e drejtorive të rrinë në mbledhje deri në fund sepse ne si asamblistë po kemi pyetje të ndryshme që bijnë në fushën e një prej drejtorëve, që shumicën e rasteve nuk janë prezent deri në fund të mbledhjes së Kuvendit.
Drejtori, Jashar Dobraj- thotë, kërkesa e asamblistit i drejtohet kryetarit të komunës, pastaj kryetari e autorizon drejtorin për të dhënë përgjigje në një çështje të caktuar.

Mon Selmonaj- ka ngritë çështjen e krijimit të tollovisë në qendër të qytetit, te rreth rrotullimi në qendër, ku po krijohet fyt i ngushtë dhe kërkohet aty vetëm heqja e dy vazove dhe rruga lirohet dukshëm aty.
Hyri Dobrunaj- thotë se kemi marrë vendim që kërkesat që vijnë deri me dt.15 të muajit shqyrtohen, ndërsa ato që vijnë pas asaj date mbesin për tu shqyrtuar mbledhjen e muajit tjetër, në vazhdim paraqet kërkesën për një takim me Kryetarin ku do të bëhen vetëm pyetje për kryetarin dhe natyrisht përgjigje nga ana e kryetarit.
Vatan Istrefaj- pyetje për gjithë ato rrugë dhe rrugica që janë hapë dhe kanë thënë se brenda muajit qershor kryhen, kërkoj njoftim deri ku kanë shku punimet dhe a do të kryhen brenda muajit qershor siç është deklaruar këtu (pyetje për drejtorin e shërbime publike , Izet Zenuni), për drejtorin e shëndetësisë, në kohë të pauzës mos të dalin në pushim gjithë stafi mjekësorë, sepse pacientët nuk presin aty, por të bëhet një orar që edhe në kohë pauze dikush nga mjekët dhe motrat të punojnë.
Drejtori i bujqësisë, Rifat Stojkaj- përgjigjet se vitin e kaluar i kemi krye 23 kanale të ujitjes, nuk e kemi vazhdu marrëveshjen me Drinin e Bardhë sepse nuk kanë pasë Bord funksional, në vazhdim drejtori është përgjigjë dhe ka sqaruar për shumë punë të kryera me sukses nga drejtoria për bujqësi.
Orges Tafilaj- pyet, a ka pasë mundësi të bëhet një marrëveshje edhe pse nuk ka pasë bord kompania apo të pritet koha e verës kur kanalet duhet me qenë të kryera dhe duke funksionuar.
Florim Mataj- thotë se jemi kundër asaj marrëveshje me Drinin e Bardhë dhe është ma mirë ne vet me i qitë ato mjete dhe me i qelë kanalet pa u perzie fare me ata.
Yllarta Thaqi- pyet, a ban ate marrëveshje mi lidhë me kompaninë Higjiena dhe me i krye ata këto kanale, meqenëse kanë mjete të punës.
Drjtori, Rifat Stojkaj- thot se kjo nuk është zgjedhje afatgjatë
Miftar Ahmetxhekaj- kërkon sqarim, cilat rrugë janë pjesë e marrëveshjes me Ministrinë e infrastrukturës –rrugët në Llotin 2 .
Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse
Dyke Llolluni

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

Asambleja
01.Nr.XI
Deçan,dt.17.08.2022

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e XI-të me radhë, mbledhja e parë e jashtëzakonshme e Asamblesë Komunale, mbajtur me dt.17.08.2022.

Në mbledhje ishin prezent: 18 anëtarë të asamblesë, tre drejtor të drejtorive komunale (drejtori administratës, drejtori i Inspekcionit dhe drejtoresha e buxhetit).

Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, z.Hajdar Sutaj.

Për mbledhje ishte propozuar ky rend pune:

1. Marrja e vendimit për shpalljen e pronës me interes të përgjithshëm publik dhe ate vetëm për lokalin afarist të ish Bankos-it i cili gjendet në objektin Banesor-Afarist në ngastrën kadastrale me nr.1256-0, Z.k. Deçan, sipas matjeve në teren sipërfaqja e lokalit është 66.92m², lokali ka edhe një sipërfaqe reklamuese (vitrinë) prej 6.34 m², që në total bëjnë 73.26m².

Kryesuesi e hapi mbledhjen e XI-të me radhë, gjegjësisht mbledhja e I-rë e jashtëzakonshme e Kuvendit, duke i përshëndetë pjesëmarrësit, verifikoj pjesëmarrjen e delegatëve dhe konstatoj se në mbledhje marrin pjesë 18 anëtarë të Kuvendit.

Kryesuesi- e prezantoj rendin e punës të propozuar me ftesë, pika e vetme e mbledhjes së jashtëzakonshme, i njëjti rend dite miratohet njëzëri.

Kryesuesi-e prezantoj pikën pastaj ka shtuar se ka qenë e nevojshme thirrja e kësaj mbledhje edhe pse kuvendi është në pushim vjetor, për arsye se AKP na ka njoftuar përmes shkresës të cilën e kini në dispozicion edhe ju, se do ta qet në privatizim atë pronë nëse ne si komunë nuk i zhvillojmë procedurat e shpalljes së pronës me interes, në vazhdim kryesuesi fjalën ia kalon Hasan Hulaj, i autorizuar nga kryetari i Komunës për të dhënë sqarime rreth kësaj teme.

Hasan Hulaj- sqaron se prona gjendet në objektin banesor afarist në ngastrën nr.1256-0 dhe bëhet fjalë për lokalin afarist të ish Bankosit, për të cilin AKP ka përgatitë procedurat për ta qitë në privatizim nëse ne si komunë nuk i ndërmarrim veprimet e duhura, fillimisht të shpalljes së pronës me interes për komunën e pastaj duhet të vazhdohet me procedurën e shpronësimit, hapësira që janë të nevojshme për shfrytëzim për zyre të komunës, përndryshe në ato hapësira janë të vendosura tash zyrat e PDK-së, AKP-ja na ka dërgua shpresën të cilën e kini në dispozicion, dhe prej këtij momenti nëse votohet ky vendim atëherë ne si komunë do të fillojmë me procedurat e shpronësimit.

Leotrim Hadergjonaj- ka thënë se AKP-ja ka përgatitë dokumentacionin për privatizim të lokalit afarist, por para se ta qet në privatizim me një shkresë e ka njoftua komunën për hapat që do të ndërmerr nëse komuna nuk e shpallë si pronë me interes, Kryetari i Komunës ka kërkuar që prona të hiqet nga procesi i privatizimit, AKP-ja është pajtuar që komuna të zhvillon procedurat për shpallje të pronës me interes dhe shpronësim të të njëjtës, ne tash për momentin duhet ta marrim vendimin për shpallje të pronës me interes për të vazhduar me procedura të shpronësimit.

Orges Tafilaj- pyet se a ka lokale tjera në objektin ekzistues në të njëjtën cilësi si ky lokal dhe nëse objekti ka me u prishë si do të trajtohet ky lokal.

Hasan Hulaj- përgjigjet se ka edhe lokale tjera në atë objekt, me status të njëjtë.

Faton Selmanaj-pyet, pse komuna ka nevojë që të zhvillon procedura për marrjen e këtij lokali dhe nuk ka shprehë interes edhe për lokalet tjera të vendosura aty.
Hasan Hulaj- përgjigjet se vetëm ky lokal ka dalë në privatizim, nëse fillojnë procedurat për privatizim edhe për ato tjerat do të veprojmë njëjtë.
Miftar Ahmetxhekaj- thotë se si parti i mbështesim punët e mira për komunën, por materiali mbështetës i kësaj pike është i pamjaftueshëm siç është fleta poseduese, propozimi i kryetarit nuk ka qëllim dhe arsyetim, pastaj shtron pyetjen, a ka ndonjë kontratë të shfrytëzimit me qira për atë lokal, a ka asete tjera komuna Deçanit që i plotësojnë kriteret e njëjta.
Hasan Hulaj- përgjigjet se Zyra e Gjeodezisë i sjellë dokumentacionet mbështetëse por ky lokal nuk ka fletë të veten poseduese të veçantë nga objekti si tërësi, ekziston vetëm Fleta poseduese e objektit në tersi.
Leotrim Hadergjonaj-thotë se AKP-ja e ka qitë në privatizim dhe kjo tregon se aty nuk ka pengesa të dhënies së lokalit me qira, dhe më mirë është që prona të kthehet në pronë komunale se sa të del në privatizim.
Mon Selmonaj- thotë se ne si PDK e kemi një marrëveshje me ish kryeshefin e komunës për shfrytëzim të lokalit për zyra të partisë – PDK, shfrytëzim me qira me afat deri në fund të këtij viti. Kjo temë është dashtë të qitet në rend dite në mbledhje të rregullt sepse shkresa nga AKP kishte kohë që kishte ardhur sepse ka datë të caktuar aty, e jo me i prishë pushimet asamblistët për të ardhë në mbledhje të jashtëzakonshme në gusht i cili është muaji i pushimit për ne.
Unë kam një hall, se në propozim thuhet se lokali nevojitet për zyra të komunës, dhe kërkoj që nëse merret ky vendim atëherë të ceket tekstualisht që lokali do të jetë në shfrytëzim të komunës dhe vetëm për interesa të komunës, dhe nëse kryhet ky proces, ku do të vendosemi ne si parti, pasi që kemi kontratë për shfrytëzim të lokalit deri në fund të vitit, dhe pas diskutimit të tij që kishte të bënte me marrje të vendimit për zyret e PDK-së, Moni e ka lëshuar sallën në shenjë pakënaqësie.
Kryesuesi- thotë me dt.27.07.2022 është protokollua dhe zyrtari zu shkresa si dokument dhe nuk kemi pasë kohë tjetër për të ftuar mbledhje, prandaj për shkak të urgjencës është dashtë të thirret kjo mbledhje e jashtëzakonshme, por pajtohem edhe unë që si pronë mos të tjetërsohet por të përdoret vetëm për nevoja për zyre të komunës.
Hasan Hulaj- thotë se beson se deri me 31 dhjetor nuk do të mund të kryhen procedurat dhe lokali deri atëherë do të jetë në dispozicion të PDK-së sipas kontratës mbi qiranë.
Kryesuesi- e qiti në votim propozimin e kryetarit të komunës për shpalljen e pronës me interes të përgjithshëm publik dhe atë vetëm për lokalin afarist të ish Bankos-it i cili gjendet në objektin Banesor-Afarist në ngastrën kadastrale me nr.1256-0, Z.k. Deçan, sipas matjeve në teren sipërfaqja e lokalit është 66.92m^2, lokali ka edhe një sipërfaqe reklamuese (vitrinë) prej 6.34 m^2, që në total bëjnë 73.26m^2, me sugjerimin që si pronë mos të tjetërsohet por të përdoret sipas kërkesës së bërë, vetëm për nevoja për zyre të komunës.
Anëtarët e kuvendit e miratojnë me shumicë votash, rezultati i votimit 11 për(pozita) 6 abstenim (opozita 3-VV dhe 3 LDK).

Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse
Dyke Llolluni

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ